



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 16276/10725/6169/3389 regj.themeltar

Nr. 211 vendimi

Dt. 05.02.2020

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit me trup gjykues të përbërë nga:

Kryesuese: Alkelina Gazidedja

Anëtar: Amarildo Laçi

Anëtar: Bari Shyti

Asistuar nga sekretarja gjyqësore [REDACTED], sot më dt. 05.02.2020 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative me palë:

PADITËS: Universiteti i Tiranës.

TË PADITUR: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
Në mungesë të Avokaturës së Shtetit, Zyrës Vendore Tiranë.

OBJEKTI: Kundërshtimi i pikave 2 dhe 3 të Vendimit nr. 140 datë 23.9.2016 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe shfuqizimi i tyre.

BAZA LIGJORE: Neni 42 pikat 1 dhe 2 të Ligji nr. 8417 datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar; Nenet 7, 11, 15, 17 të ligjit 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" Nenet 32, 36, 43, e ne vijim të Kodit të Procedurës Civile të ndryshuar; Nenet 115 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative; Nenet 3 pika 4 germa q), 57 neni 64 dhe nenet 103 e ne vijim të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor ne institucionet e arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor ne RSH" nenet 63, 64, 65, 66 dhe 67 të Statutit të UT të miratuar nga Senati Akademik me 16.12.2009 të ndryshuar; Nenet 25 dhe 27 të Rregullores së UT të miratuar me vendim të Senatit Akademik nr.5 datë 12.4.2010 të ndryshuar; Nenet 1, 2, 5, 12, 13, 21,

32 dhe 33 të ligjit nr.10221 datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pasi ka marrë në shqyrtim çështjen me vendimin Nr.304(80-2017-325) datë 06.02.2017, ka vendosur:

- Rrëzimin e padisë së palës paditëse Universiteti i Tiranës, si të pambështetur në ligj dhe në prova.
- Shpenzimet gjyqësore janë në ngarkim të palës paditëse.
- Kundër vendimit mund të bëhet ankim në gjykatën administrative të apelit Tiranë, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.

Kundër vendimit ka bërë ankim pala paditëse, e cila kërkon ndryshimin e vendimit duke vendosur pranimin e ankimit, duke parashtruar këto arsye:

- Ky qëndrim i KMD dhe i gjykatës është i gabuar, cenon autonominë institucionale në vendosjen e kriterëve si dhe përbën shkak për diskriminimin e drejtpërdrejtë të të gjithë kandidatëve të tjerë që mund të plotësojnë të gjitha kriteret. Gjykata në këtë analizë ka cënuar gjithashtu natyrën e këtyre kriterëve duke dashur t'i japë një natyrë fakultative ku plotësimi i njërit prej tyre nuk sjell detyrimisht plotësimin e kriterëve të tjerë kur në fakt këto kriterë kanë natyrë kumulative pra, eventualisht bazuar në parimin e një konkurrence të drejtë, vendin e punës e fiton kandidati më i mirë dhe më i përgatitur.
- Komisioneri gjatë trajtimit të rastit konkret të kandidatit ankues për personel akademik në UT në Tetor 2015, ka konsideruar se është bërë s'kualifikimi i tij për shkak të notës mesatare nën 8 në studimet e ciklit/nivelit të parë dhe për shkak se nuk kishte të njehsuar diplomën e studimeve të ciklit të dytë, të cilat i kishte kryer jashtë shtetit. Sipas Komisionerit, ky s'kualifikim për këtë shkak përbën diskriminim të tërthortë. Komisioneri tregohet kontradiktor në vendimin nr.140, datë 23.09.2016, pikat 1 dhe 2 të tij. Mos për zgjedhja e kandidatit është bërë për disa arsye. Ai jo vetëm nuk përmbushte kriterin e notës mesatare mbi 8, kriter ky që kërkohet në çdo rast për të gjithë kandidatët, edhe për ata që kanë një diplomë, gradë shkencore ose titull akademik, por edhe nuk ka njohur në Shqipëri diplomën e ciklit të dytë të fituar në SHBA dhe për këtë shkak kjo diplomë e panjësuar në kuptim të ligjit nuk konsiderohet si e marrë. (citohet neni 37 i ligjit nr.9741 datë 21.4.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar).
- Për këto shkaqe, ky rast nuk mund të shërbejë si bazë për vlerësim nga ana e Komisionerit për diskriminim. (citohet neni 3, pika 3 e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi). Që të konsiderohet një rrethanë si diskriminim, duhet që personi i konsideruar si i diskriminuar të mos ndodhet nën kushte të njëjta me personat e tjerë. Të gjithë kandidatët vlerësohen sipas një pikëzimi të bërë nga komisioni *ad hoc*, ku kandidatët që kanë diplomë doktorate ose titull akademik (për plotësimin e

- këtij kriteri) marrin më shumë pikë nga kandidatët e tjerë. I njëjti vlerësim është bërë në rastin e kandidatit, për të cilin komisioneri ka vlerësuar se ka diskriminim.
- Nga ana tjetër, nuk mund të konsiderohet diskriminim rasti konkret, kur kandidati nuk përmbush kriteret e përgjithshme të vendosura nga departamentet - notën mesatare nga cikli i parë i studimeve dhe njohjen e diplomës së ciklit të dytë. Në këto kushte kandidati ka aplikuar duke patur diplomën e ciklit të parë dhe të cilën nuk e ka në fushën e kërkuar e njëkohësisht nuk e ka me notën mesatare të kërkuar. Gjatë hetimit administrativ, Komisioneri është sqaruar se kriteret vendosen rast pas rasti sipas nevojave të departamenteve dhe në mënyrë proporcionale, duke u aplikuar kriteret të arsyeshme të tilla si nota mesatare, kualifikimet, titujt dhe gradat, gjuhët e huaja, punimet shkencore etj. në raport këto me kërkesat që departamenti ka sipas rastit.
 - Referuar sa parashikon VKM nr.331, datë 25.3.2009 “Për ndarjen në nivele, brenda kategorive, të personelit akademik, në institucionet e arsimit të lartë, emërtimin e renditjen e tyre, si dhe kriteret dhe kualifikimet për secilin vend pune”, mundet që departamenti të mos ketë nevojë për personel të mbikualifikuar, pasi do të nevojitej dhënia e ngarkesës mësimore sipas titullit, me leksione, dhënie lënde në ngarkim, gjë e cila nuk është e mundur në çdo rast, pasi departamenti mund ta mbulojë ngarkesën mësimore me stafin që ka dhe të ketë nevojë për personel akademik për seminare, laboratorë e praktika mësimore, të cilat i zhvillojnë stafi i kategorisë lektor ose asistent lektor.
 - Për sa më sipër, nuk mund të pretendohet se nga ana e Universitetit të Tiranës janë diskriminuar në mënyrë të tërthortë kandidatët, të cilët kanë patur të mbrojtur një gradë apo titull shkencor. (Citohet neni 64, pika 1 e ligjit 80/2015). Bazuar edhe në Statutin e UT (citohet neni 63 i tij mbi kërkesat e përgjithshme dhe tagrin e njësive përkatëse për të përcaktuara kërkesat e veçanta), është në interes të Universitetit të Tiranës që të vendosë kriteret të veçanta në konkurrimin e punësimeve, të cilat potencialisht do të ndikojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies.
 - Komisioneri nuk mund të japë një rekomandim që tejkalon ligjin, pasi referuar nenit 64 të ligjit, kriteret e punësimit i përcaktojnë vetë departamentet sipas nevojave. Jo me kot ligji ka bërë një përcaktim të tillë, pikërisht për të lënë të hapur mundësinë për vlerësim rast pas rasti. Ate që ligji e lejon dhe autorizon si pjesë të autonomisë organizative universitare, nuk mundet ta kufizojë komisioneri me një vendim.
 - Komisioneri në vendimin nr. 140, date 23.09.2016 është shprehur se: “Për kandidatët të cilët kanë mbrojtur një grade apo një titull shkencor (doktor, docent, profesor i asociuar, profesor) sipas niveleve të kualifikimit akademik, Fakulteti i Shkencave Sociale rekomandohet të vendosë kriteret të diferencuara sipas shkallës së kualifikimeve. Kjo pikë është në kundërshtim me ligjin e ri për arsimin e lartë dhe ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pasi nuk ka arsye që plotësimi i një kriteri të jetë kusht për mosplotësimin e kriterëve të tjera. Pra, plotësimi i kriterit të notës mesatare të ciklit të I dhe të II, dhe fitimi i gradës apo titullit shkencor të kandidatit, sjell kualifikimin e duhur për fushën në të cilën UT është i interesuar.

- Komisioneri vlerëson se nota mesatare e ciklit të I dhe të II të studimit mund të jetë kriter vlerësues nëse të gjithë kandidatët i përmbushin të gjitha kriteret dhe se kriteret dhe kualifikimet duhet të jenë të diferencuara sipas shkallës së kualifikimit të kandidatëve dhe se vendosja e kufizimeve për kandidatët, duhet bërë vetëm në rastet kur është absolutisht e nevojshme mbrojtja në veçanti e interesave të rëndësishme të palëve të interesuara. Nga ky arsyetim i Komisionerit, kërkohet që rast pas rasti, UT të ndryshojë kriteret dhe njëkohësisht të ulë standardin e vendosur për të gjithë kandidatet e tjerë, lidhur me rezultatet që ata kanë marrë gjatë ciklit të parë dhe të dytë. Arsyetimi i sipërcituar është abuziv, pasi qëllimi dhe interesi më i lartë për UT është rritja e cilësisë dhe e standardit sa i përket mësimdhënies. Vendimi i KMD-së bie në kundërshtim me politikat e Universitetit të Tiranës dhe me frymën e ligjit nr.80/2015, në themel të të cilit është sigurimi, përmirësimi dhe rritja e vazhdueshme e cilësisë së arsimit të lartë, të realizueshme këto edhe nëpërmjet përzgjedhjes së kandidatëve/pedagogëve më të përshtatshëm dhe më të kualifikuar, të cilët bazuar në eksperiencën e tyre do të rrisin performancën dhe cilësinë e mësimdhënies në Universitetin e Tiranës.
- Si përfundim, nëse do të përcaktoheshin kriteret të diferencuara që me shpalljen e konkursit, atëherë do të bëhej diskriminim dhe paragjykim ndër kandidatët dhe konkursi nuk do të kryhej, por nga ana tjetër, departamentet nuk do të përmbushin dot kërkesat dhe nevojat e tyre.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Pasi degjoi relatimin e çështjes nga gjyqtarja Alkelina Gazidedja dhe shqyrtoi çështjen në dhomë këshillimi,

VËREN

Se pranë Gjykatës Administrative të Apelit ka ardhur për gjykim çështja administrative me palë dhe objekt të sipërcituar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në bazë të ankimit të bërë nga pala paditese.

Gjykata së pari, verifikoi ankimin e bërë nga pala paditëse nëse i plotëson kushtet e pranueshmërisë, fakt ky që është verifikuar me vendimin datë 31.08.2017, të gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë sipas kërkesave të nenit 46 - 48/2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, konstatoi se ankimi i plotëson kushtet e pranueshmërisë.

Rrethanat e faktit

Nga aktet në dosje rezultojnë e provuar se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka nisur hetimin administrativ bazuar në ankesën nr.90, datë 16.11.2015, të paraqitur nga subjekti ankues z. [REDAKTUAR], i cili ka pretenduar diskriminim për shkak të “gëndjes arsimore” nga ana e zv. Rektorit të Universitetit të Tiranës, Dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës dhe Përgjegjësit të Departamentit të Shkencave Politike.

Subjekti ankues, ndër të tjera ka parashtruar se, në datë 12.10.2015, ka dorëzuar dokumentacionin pranë zyrës së burimeve njerëzore të Fakultetit të Shkencave Sociale, për të aplikuar për dy pozicionet e punës si punonjës mësimor pranë Departamentit të Shkencave Politike të shpallur në Buletinin e APP-së. Në datë 24.10.2015 nga një punonjëse e zyrës së burimeve njerëzore të Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës i është dorëzuar një shkresë në të cilën vihet në dijeni se pas verifikimit paraprak të dokumentacionit, aplikimi i tij nuk plotësonte dy kritere: 1 - Të jetë i diplomuar të paktën në dy cikle në fushën e shkencave politike dhe; 2 - Të ketë notën mesatare të studimeve bachelor mbi 8 dhe master mbi 8. Ankuesi ka pretenduar se në aplikimin për pedagog të bërë në vitin 2014 nuk është “skualifikuar” që në fillim nga lista e atyre që u kualifikuan për intervistë, siç ndodhi në aplikimin e dytë në Tetor 2015, por ka dalë përpara komisionit vlerësues të kryesuar nga zv.Rektori, i cili ka nxjerrë si justifikim për mos punësimin e tij, faktin që mesatarja e studimeve Bachelor ishte 7.964. Ankuesi ka shpjeguar para Komisionerit se ai plotëson kriterin e notës mesatare dhe zotëron dy cikle studimi në Shkenca Politike, dhe se justifikimi i përdorur prej drejtuesve të UT shkon kundër logjikës normale akademike të përdorur në universitetet në Amerikë dhe Evropë, pasi kur kërkohet të punësohet një pedagog, kriteri i parë dhe më i rëndësishëm është që kandidati të ketë një PhD, ta ketë në fushën përkatëse, të ketë kërkim shkencor dhe plane botimi si dhe të jetë në gjendje të japë mësim një numër lëndësh që kanë lidhje direkte me fushën.

Universiteti i Tiranës në shpalljen e vendit të punës thotë se kandidati duhet të ketë “Doktoraturë” por në vlerësimin konkret, përdor si “metër matës” diplomën e bachelorit, i cili nuk mund të aplikohet në emër të interesit të universitetit dhe studentëve.

Përmes kësaj ankese, [REDAKTUAR] ka kërkuar nga Komisioneri që të konstatojë se praktikat e ndjekura nga Universiteti i Tiranës janë diskriminuese jo vetëm për të, por dhe ndaj të gjithë personave që kanë përfunduar doktoraturën jashtë vendit .

Në zbatim të parashikimeve ligjore në nenet 32 dhe 33 të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë veprimet e pasqyruara në vijim.

Me shkresën nr. 937/1, datë 24.11.2015 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjektit Universiteti i Tiranës, në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga z. [REDAKTUAR]

Me shkresën Nr. 1165/5, datë 14.12.2015 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Fakulteti i Shkencave Sociale i Universitetit të Tiranës informon se: “Aplikimet për punë të z. [REDAKTUAR] nuk janë pranuar nga ana e Fakultetit të Shkencave Sociale për dy arsye. Së pari nuk plotëson kriterin e notës mesatare të ciklit bachelor (mbi 8) dhe të masterit (mbi 8), pasi z. [REDAKTUAR] ka mbaruar studimet universitare në degën Gjuhë-Letërsi me mesatare 7.96 dhe jo mbi 8. Së dyti, nuk plotëson kriterin që të jetë i diplomuar të paktën në dy cikle në fushën e shkencave politike. Për të plotësuar këtë kriter, kandidati duhet të kishte të paktën Master Shkencor në fushën e Shkencave Politike (të njehsuar nga MAS) dhe Doktoraturë në Shkenca Politike (të njehsuar nga MAS), pra të paktën ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve. Z. [REDAKTUAR] disponon “Master of Arts” (të njehsuar nga MAS). Fituesit për vendet e lira të shpallur në Buletinin e APP-së janë kandidatët të cilët plotësonin kriteret e përgjithshme dhe ato preferencialë....”.

Me shkresën nr. 937/2, datë 24.11.2015, nga KMD i është kërkuar subjektit ankues plotësimi i dokumentacionit dhe informacion shtesë në lidhje me ankesën.

Me shkresën nr. 61 datë 14.01.2016 të KMDs-së janë njoftuar palët për realizimin e një seance dëgjimore mes tyre, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet lidhur me ankesën në fjalë.

Më datë 21.01.2016 në mjediset e zyrës së Komisionerit u zhvillua seanca dëgjimore, ku morën pjesë, juristja pranë Universitetit të Tiranës [REDAKTUAR] dhe subjekti ankues.

Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore ankuesi ka deklaruar se: "Refuzimi i aplikimit të tij nga Fakulteti i Shkencave Sociale është diskriminues për shkak të origjinës amerikane të formimit të tij profesional dhe akademik, të superioritetit të formimit të tij akademik në nënfusha të shkencave politike ashtu dhe në metodologji si dhe për shkak të qëndrimeve dhe ideve të tija të spikatura publikisht, të cilat kanë qenë jo thjesht kritike të gjendjes në universitetet shqiptare por dhe kanë kërkuar bërjen e ndryshimeve. Sipas ankuesit diskriminimi i tij për shkak të gjendjes arsimore, përfaqëson nga ana e universitetit një praktikë diskriminuese në raport me kandidatët e tjerë konkurrues duke përdorur kriterin e notës mesatare dhe të diplomimit në dy cikle në fushën e shkencave politike".

Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, përfaqësuesja e Universitetit të Tiranës ka deklaruar se: "Nevoja për vendosjen e kriterit të diplomimit në dy cikle në fushën e shkencave politike nga ana e departamentit, ka qenë për arsye se departamenti i shkencave politike është i ri, i krijuar në vitin 2008, me përbërje fillimisht personel akademik të formimit të përgjithshëm në shkenca sociale ose me kualifikime të përafërta në këtë fushë dhe për këtë arsye kandidatët duhet të jenë të kualifikuar në vijimësi në dy cikle për shkenca politike, ndërsa kriteri i vendosjes së mesatares së lartë ka të bëjë me cilësinë e kandidatit dhe është kriter që vendoset në çdo konkurrim pune të çdo fakulteti. Znj. [REDAKTUAR] shpjegoi se vendosja e kriterëve vlerësohet nga nevojat që kanë departamentet për staf mësimor dhe mund të jenë të ndryshme".

Me shkresën nr.137/2, datë 28.01.2016, Rektorati i Universitetit të Tiranës ka informuar Komisionerin mbi ankesën e paraqitur, duke parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të detajuar procedurat e ndjekura për konkursin për punonjës mësimor në Departamentin e Shkencave Politike.

Me shkresën nr. 575, datë 31.05.2016 i është kërkuar Universitetit të Tiranës të japë shpjegime në lidhje me proporcionalitetin e vendosjes së kriterit përjashtues të notës mesatare mbi 8 në ciklin bachelor, në rastin kur një kandidat ka përfunduar me sukses dy cikle studimi (master dhe doktoraturë) në fushën e kërkuar, arsyetimin e përdorur nga departamenti për vendosjen e këtyre kriterëve si dhe nëse vendosja e këtyre kriterëve për rekrutimin e stafit akademik i referohet ndonjë eksperience në Universitetet Evropiane apo të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Me shkresën nr.137/5, datë 09.06.2016, Rektorati i Universitetit të Tiranës ka informuar Komisionerin si më poshtë: "Universiteti i Tiranës në praktikën e deritanishme të ndjekur, gjithmonë në një procedurë punësimi është kërkuar nota mesatare e studimeve si një tregues i cilësisë dhe profesionalizmit. Kriteret e punësimit përcaktohen nga njësia bazë sipas nevojave që ka departamenti në bazë të lëndëve dhe të ngarkesës mësimore të pedagogut. Në Statutin dhe Rregulloren e UT nuk ka një rregullim apo përcaktim mbi mënyrën e përcaktimit të kriterëve të punësimit për staf pedagogjik. Universiteti i Tiranës sqaron se,

për vendosjen e kriterëve të punësimit, bazohet në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin dhe Rregulloren e UT si dhe në praktikat më të mira që janë ndjekur deri më tani”.

KMD, pasi ka marrë në analizë pretendimin e subjektit ankues se është diskriminuar për shkak të gjendjes arsimore përmes procedurës së punësimit për personel akademik, ka arritur në përfundimin se nuk ka patur trajtim më pak të favorshëm të [REDAKTUAR], krahasuar me aplikantët e tjerë, pra se ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë nga ana e Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale në krahasim me aplikuesit e tjerë, për shkak të gjendjes arsimore .

Lidhur me pretendimin tjetër të ankuesit se kriteret e përgjithshme të vendosura në konkurrimin për vendet e lira për personel akademik janë diskriminuese, KMD ka pranuar ankimin duke konkluduar se kandidatët që kanë të mbrojtur një gradë apo titull shkencor (të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit) si doktor, docent, profesor i asociuar, profesor, diskriminohen në mënyrë të tërthortë nga vendosja e kriterit të notës mesatare të ciklit të I dhe të II të studimit.

Në përfundim të hetimit administrativ, pasi ka mbledhur informacionin e nevojshëm dhe ka vlerësuar në referim të ligjit situatën e ankuesit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me vendim nr.140 datë 23.09.2016, ka vendosur:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasit [REDAKTUAR] nga ana e Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, lidhur me procedurën e rekrutimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve për vendet e punës në Departamentin e Shkencave Politike, për shkak të gjendjes arsimore.
 2. Konstatimin e diskriminimit të tërthortë të kandidatëve që kanë të mbrojtur një gradë apo titull shkencor (doktor, docent, profesor i asociuar, profesor) për shkak të gjendjes arsimore.
 3. Në referim të pikës 2, Fakulteti i Shkencave Sociale, rekomandohet që të vendosë kriteret të diferencuara sipas shkallës së kualifikimit të kandidatëve.
 4. Universiteti i Tiranës, rekomandohet që të parashikojë në aktet nënligjore, detyrimin e njëjësive bazë për të shpjeguar me shkrim në mënyrë të arsyetuar vendosjen e kriterëve të propozuara.
 5. Bazuar në nenin 33, pika 11, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave Sociale detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
 6. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Në pjesën arsyetuese të këtij vendimi për pjesën e pranuar të ankimit, KMD, ndër të tjera analizon si më poshtë vijon:

“Referuar legjislacionit në fuqi dhe dokumentacionit të shqyrtuar në lidhje me procedurat e punësimit për personelin mësimor, vërehet se në aktet e përmendura nuk ka një rregullim të saktë dhe të qartë mbi mënyrën e përcaktimit të kriterëve të punësimit për staf pedagogjik si

dhe nuk është përcaktuar detyrimi që duhet të kenë njësitë përkatëse (Departamenti) për të shpjeguar me shkrim në mënyrë të arsyetuar vendosjen e kritereve të propozuara.

Duke iu përmbajtur kritereve të përcaktuara në Buletinin nr.38, datë 28.09.2015, rezulton se në bazë të tij, përjashtohen nga konkurrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjithë kandidatët që kanë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master nën 8, si dhe të cilët nuk janë diplomuar të paktën në dy cikle në fushën e shkencave politike, pavarësisht se mund të jenë me tituj shkencorë më të lartë se kriteret e kërkuara. Ky kriter bëhet dhe më i pakuptimtë kur kandidati plotëson kriterin e diplomimit në master dhe doktoraturë në fushën e shkencave politike por studimet e ciklit bachelor i ka në një degë tjetër, kusht në të cilin ndodhet ankuesi dhe ndonjë kandidat i skualifikuar...” (shih faqet nr.8-9 të vendimit 140/2016 të KMD).

Vendimi nr.140 datë 23.09.2016 i është komunikuar Universitetit me shkresën e KMD nr.875/1 prot datë 23.09.2016.

Pala paditëse i është drejtuar gjykatës administrative të shkallës së parë Tiranë, me objekt të padisë shfuqizimin e vendimit objekt gjykimi.

Me shkresën nr.137/10 prot datë 26.10.2016, Rektorati pranë UT, në zbatim të pikës 5 të vendimit 140/2016 të KMD-së, njofton këtë të fundit se ka depozituar ankim gjyqësor lidhur me pikat 2 dhe 3 të vendimit, ndërsa lidhur me pikën 4 të tij, ndodhet në fazën e hartimit të akteve të brendshme (Statut dhe Rregullore), në të cilat do të parashikohet detyrimi i lënë njësitë bazë për të shpjeguar me shkrim në mënyrë të arsyetuar vendosjen e kritereve të propozuara.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pasi ka marrë në shqyrtim çështjen me vendimin Nr.304(80-2017-325) datë 06.02.2017, ka vendosur:

- Rrëzimin e padisë së palës paditëse Universiteti i Tiranës, si të pambështetur në ligj dhe në prova.
- Shpenzimet gjyqësore janë në ngarkim të palës paditëse.
- Kundër vendimit mund të bëhet ankim në gjykatën administrative të apelit Tiranë, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka arsyetuar midis të tjerave se:

Së treti: Lidhur me thelbin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata analizon pretendimet e palëve në referim të kuadrit ligjor dhe gjendjes së provave të administruara në gjykim.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” përcaktohet një listë joshteruese shkaqesh diskriminimi, ku “gjendja arsimore” është një nga shkaqet e parashikuara për të cilin Ligji ofron mbrojtje.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe

jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në vlerësim të nenit 33 të ligjit nr. 10221/2010, ankesa e shtetasit [REDAKTUAR] është vlerësuar nga KMD se përmban elementët formalë të kërkuar nga ky ligj dhe me të drejtë është proceduar me shqyrtimin e saj.

Komisioneri për mbrojtjen nga Diskriminimi, në kompetencat që i jep Ligji 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" nuk ka tagër për të dhënë dëshmipërblim, por në nenin 34/1, të ligjit përcaktohet se: "Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1, të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesë padi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëshmipërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzim përpara organeve kompetente për ndjekje penale".

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në përfundim të hetimit të tij administrativ, ka arritur në përfundimin se ankesa gjendet pjesërisht e pranueshme, sa i takon pretendimit se kriteret e përgjithshme të vendosura në konkurrimin për vendet e lira për personel akademik janë diskriminuese, duke konkluduar shprehimisht se: kandidatët që kanë të mbrojtur një gradë apo titull shkencor, të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (doktor, docent, profesor i asociuar, profesor) diskriminohen në mënyrë të tërthortë nga vendosja e kriterit të notës mesatare të ciklit të I dhe të II të studimit.

Fakulteti i Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës në Buletinin nr.38, datë 28.09.2015 të Agjencisë së Prokurimit Publik, ka shpallur njoftimin për dy vende të lira pune për punonjës mësimorë pranë Departamentit të Shkencave Politike në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës. Në kriteret e përgjithshme të kërkuara në këto aplikime, kandidatët duhet që mes të tjerash, të ishin të diplomuar të paktën në dy cikle në fushën e Shkencave Politike, të kishin notën mesatare të studimeve (bachelor dhe master) mbi 8 dhe në kriteret e veçanta, preferoheshin që kandidatët të zotëronin gradën Doktor në fushën e Shkencave Politike.

Ankuesi në rastin konkret, është certifikuar në njohuritë e profilizuara, sipas dokumentacionit të paraqitur dhe të verifikuar nga Komisioneri e konkretisht:

- Me Diplomën nr. 2509-B, datë 22.04.1997 ka mbaruar kursin e plotë të Fakultetit Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës, në degën Gjuhë-Letërsi.
- Ka kryer studimet master në Universitetin e Nebraskës SHBA dhe është pajisur me diplomën "Master of Arts" (të pa njehsuar nga MAS).
- Ka fituar gradën "Doctor of Philosophy" në Universitetin e Cincinatit SHBA të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës me vërtetimin nr.6855/5, datë 20.12.2012, të barasvlefshme me gradën shkencore "Doktor" në Republikën e Shqipërisë.

Bazuar në kriteret e shpallura, ankuesi ka aplikuar për të konkurruar për këto vende pune dhe është skualifikuar për mosplotësim të kriterëve: -Të jetë i diplomuar të paktën në dy cikle në fushën e shkencave politike dhe; - të ketë notën mesatare të studimeve Bachelor dhe Master mbi 8.

Gjykata e gjen me vend të sqarojë se, konstatimi i KMD mbi diskriminimin e tërthortë ndaj kandidatëve në këtë proces konkurimi, të cilët kanë mbrojtur një gradë apo titull shkencor, siç është grada shkencore "Doktor" e ankuesit, lidhet specifikisht me vendosjen e kriterit të notës mesatare të ciklit të I dhe të II të studimit. Analiza e kryer nga Komisioneri nuk vë në

diskutim që diploma e nivelit master, nuk i është marrë në konsideratë ankuesit, pasi nuk ka qenë e njehsuar nga MAS sipas procedurës së parashikuar në nenin 92 të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL", pikat 2 deri 4 të të cilit parashikojnë se: 2. Një kualifikim apo program studimi i kryer jashtë vendit, për të cilin është lëshuar një certifikatë, diplomë apo gradë nga institucioni i huaj, i autorizuar në vendin përkatës për lëshimin e tyre, që vërteton përfundimin e kualifikimit apo programit të studimit, vlerësohet, njihet dhe njësohet në bazë të Kornizës Europiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës dhe të Kornizës së Kualifikimeve të Republikës së Shqipërisë, sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, në të cilat përfshihet vendi ynë. 3. Institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin zyrtar, në Republikën e Shqipërisë, të certifikatave, diplomave dhe gradave shkencore është ministria përgjegjëse për arsimin. Ky proces kryhet nga njësia përgjegjëse e njësimit të diplomave. 4. Titujt e lëshuar jashtë vendit nga një institucion i huaj i arsimit të lartë njihen në Republikën e Shqipërisë, të barasvlershëm nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar punësimin ose karrierën akademike në Shqipëri, përmes procedurës zyrtare të njohjes. Ligji përcakton qartë se njehsimi nga organi kompetent shqiptar i titullit të lëshuar nga një institucion arsimor i lartë, i huaj, është kusht për punësimin në sektorin akademik në Shqipëri.

Po kështu, gjykata e gjen në përputhje me ligjin argumentin e dhënë nga pala e paditur se, kriteret e punësimit i përcaktojnë vetë departamentet sipas nevojave të tyre për plotësimin me staf akademik.

Referuar legjislacionit në fuqi, procedura e punësimit të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë rregullohet sipas nenit 64/1 të ligjit nr. 80, datë 22.7.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në të cilin përcaktohet se: "Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit, dhe miratohen nga rektori".

Në nenin 25 të Rregullores së Universitetit të Tiranës, në pjesën që bën fjalë mbi përzgjedhjen dhe emërimi i personelit me kohë të plotë, përcaktohet se: "Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për personel akademik për vendet e lira të punës, propozohen nga departamenti përkatës. Dekani pasi i verifikon dhe është dakord me to, bën shpalljen e vendeve të lira të punës". Rregullorja në këtë pjesë të saj, vendos rregulla procedurale dhe e lë në diskrecion të vetë njësisë (departamentit përkatës) caktimin e kriterëve, por se këto të fundit, duhet të jenë të arsyeshme dhe në përputhje me standardin e pozicionit të punës së shpallur të lirë.

Universiteti i Tiranës ka vendosur kriterin e notës mesatare mbi 8 dhe arsimimit në vijimësi të paktën të dy cikleve në fushën përkatëse që janë bachelor dhe master. Ankuesi në rastin konkret, plotëson kriterin e diplomimit në master dhe doktoraturë në fushën e shkencave politike, por se diploma mastër nuk rezulton e njehsuar dhe studimet e ciklit bachelor i ka në një degë tjetër.

Duke qenë se ai mban titullin doktor në fushën e shkencave politike, kur dy ciklet e vlerësuar si të mjaftueshme në konkurim janë të nivelit të I dhe II të studimeve, (bachelor dhe master), përcaktimi i kriterit notë mesatare, e ka vendosur ankuesin në pozitë të

pafavorshme, në raport me kandidatët të cilët e kanë këtë mesatare, por nuk kanë gradë shkencore në fushën e kërkuar që është ajo e shkencave politike. (vlerësuar si titull akademik më i lartë në sistemin e kualifikimit profesional).

Duke iu përmbajtur kriterëve të përcaktuara në Buletinin nr.38, datë 28.09.2015, rezulton se në bazë të tij, përjashtohen nga konkurrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjithë kandidatët që kanë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master nën 8, si dhe të cilët nuk janë diplomuar të paktën në dy cikle në fushën e shkencave politike, pavarësisht se mund të jenë me tituj shkencorë më të lartë se kriteret e kërkuara. Gjykata vëren se kriteri i notës mesatare sipas vlerësimit që i ka bërë departamenti përgjegjës, është konsideruar se prevalon ndaj titujve shkencorë më të lartë të fituar nga kandidatët, siç është situata e ankuesit.

Komisioneri në vendimin e tij, ka vlerësuar se, nëse kandidatët kanë të mbrojtur një gradë apo titull shkencor sipas niveleve të kualifikimit akademik, (specifikuar grada: doktor, docent, profesor i asociuar, apo profesor) nuk ka pse të jetë kriter skualifikues nota mesatare e ciklit të I dhe të II të shkollimit, pasi mendohet se personi që ka fituar gradën apo titullin shkencor, ka kualifikimin e duhur për fushën në të cilën ka dëshminë përkatëse, aq më tepër kur diploma e ciklit bachelor nuk është e njëjtë me kualifikimin në master dhe doktoraturë.

Gjykata e gjen të drejtë arsyetimin e bërë nga Komisioneri se, nota mesatare e ciklit të I dhe të II të studimit mund të jetë kriter vlerësues nëse të gjithë kandidatët i përmbushin të gjitha kriteret. Vendosja e kriterit të notës mesatare konsiderohet i arsyeshëm, kur ajo lidhet me të njëjtin nivel të kualifikimit akademik, pasi prezumohet se në kushtet e disponimit të të njëjtës diplomë, kandidati mbi pragun e një note mesatare, garanton njohuritë e kënaqshme të vlerësuar nga stafi pedagogjik që ka e ka testuar më parë atë, pra plotëson standardin e punësimit të personelit të kualifikuar.

Nga ana tjetër, kur një kandidat disponon një titull shkencor më të lartë sesa pragu minimum i kërkuar në kriteret e shpallura (në rastin konkret ankuesi mban titullin doktor i shkencave politike, kur dy ciklet e kërkuara në fushën e shkencave politike lidheshin me diplomë të nivelit master dhe bachelor), vendosja e mesatares për diplomat e cikleve më të ulëta, shvleftëson një titull shkencor më të lartë, i cili duke qenë në rastin e paditësit në fushën e kërkuar nga Departamenti, e ka vendosur atë në pozitë të pafavorshme ndaj kandidatëve që nuk kishin studime të thelluara në fushën përkatëse, sikundër prezumon fitimi i gradës shkencore "Doktor".

Në pasojë, gjykata e gjen të drejtë qëndrimin e mbajtur nga Komisioneri se, kriteret dhe kualifikimet e kandidatëve duhet të jenë të diferencuara sipas shkallës së kualifikimit të tyre dhe se, sikundër shprehet ligji, vendosja e kufizimeve duhet bërë në rastet kur është absolutisht e nevojshme mbrojtja në veçanti e interesave të rëndësishme të palëve të interesuara dhe duhet që në të gjitha rastet, masa kufizuese e përzgjedhur të përmbajë cenimin më të vogël të mundshëm me qëllim që të sigurohet të gjithë të interesuarve e drejta për të zgjedhur profesionin dhe për të siguruar mjetet e jetesës nëpërmjet punësimit.

Ligji "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", në nenin 3, pika 3, parashikon se: "Diskriminimi i tërthortë" është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose

grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë". Gjykata konkludon se, kandidatët që kanë të mbrojtur një gradë apo titull shkencor, të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (doktor, docent, profesor i asociuar, profesor) në praktikën konkrete të konkurimit, konsiderohen të vendosur një një pozitë të pafavorshme dhe të pajustificuar nga qëllimi i ligjit, në raport me kandidatët që plotësojnë notën mesatare të ciklit të I dhe të II të studimit, në fushën specifike të shpallur, ndaj konsiderohen të diskriminuar në mënyrë të tërthortë nga vendosja e kriterit të notës mesatare.

Nga ana tjetër, KMD arsyeton në vendimin e saj se referuar legjislacionit në fuqi dhe dokumentacionit të shqyrtuar në lidhje me procedurat e punësimit për personelin mësimor, vërehet se në aktet e përmendura nuk ka një rregullim të saktë dhe të qartë mbi mënyrën e përcaktimit të kriterëve të punësimit për staf pedagogjik si dhe nuk është përcaktuar detyrimi që duhet të kenë njësitë përkatëse (Departamenti) për të shpjeguar me shkrim në mënyrë të arsyetuar vendosjen e kriterëve të propozuara. Ky qëndrim i KMD-së dhe disponuar prej saj në pikën 5 të vendimit 140/2016, është pranuar nga Universiteti i Tiranës, i cili e ka reflektuar sugjerimin në hartimin e akteve të brendshme siç janë Statuti dhe Rregullorja.

Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim pala paditëse, e cila kërkon ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë, për shkaqet e parashtruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Vlerësimi i kolegjit administrativ të apelit

Nga shqyrtimi i çështjes në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumenteve, Kolegji i Gjykatës Administrative të Apelit çmon se vendimi 304 datë 06.02.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është rezultat i zbatimit të gabuar të normave procedurale për pasojë ai duhet të prishet dhe çështja të kthehet për rigjykim.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë është rrjedhojë i një procesi jo të rregullt ligjor të zhvilluar në shkelje të rënda të rregullave procedurale dhe për këtë shkak vendimi duhet të prishet dhe çështja duhet të kthehet për rigjykim për këto arsye:

Nga aktet në dosje rezulton e provuar se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka nisur hetimin administrativ bazuar në ankesën nr.90, datë 16.11.2015, të paraqitur nga subjekti ankues z. [REDAKTUAR], i cili ka pretenduar diskriminim për shkak të "gjendjes arsimore" nga ana e zv. Rektorit të Universitetit të Tiranës, Dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës dhe Përgjegjësit të Departamentit të Shkencave Politike.

Subjekti ankues, ndër të tjera ka parashtruar se, në datë 12.10.2015, ka dorëzuar dokumentacionin pranë zyrës së burimeve njerëzore të Fakultetit të Shkencave Sociale, për të aplikuar për dy pozicionet e punës si punonjës mësimor pranë Departamentit të Shkencave Politike të shpallur në Buletinin e APP-së. Në datë 24.10.2015 nga një

punonjëse e zyrës së burimeve njerëzore të Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës i është dorëzuar një shkresë në të cilën vihet në dijeni se pas verifikimit paraprak të dokumentacionit, aplikimi i tij nuk plotëson dy kritere: 1 - Të jetë i diplomuar të paktën në dy cikle në fushën e shkencave politike dhe; 2 - Të ketë notën mesatare të studimeve bachelor mbi 8 dhe master mbi 8. Ankuesi ka pretenduar se në aplikimin për pedagog të bërë në vitin 2014 nuk është “skualifikuar” që në fillim nga lista e atyre që u kualifikuan për intervistë, siç ndodhi në aplikimin e dytë në Tetor 2015, por ka dalë përpara komisionit vlerësues të kryesuar nga zv.Rektori, i cili ka nxjerrë si justifikim për mos punësimin e tij, faktin që mesatarja e studimeve Bachelor ishte 7.964.

Ankuesi ka shpjeguar para Komisionerit se ai plotëson kriterin e notës mesatare dhe zotëron dy cikle studimi në Shkenca Politike, dhe se justifikimi i përdorur prej drejtuesve të UT shkon kundër logjikës normale akademike të përdorur në universitetet në Amerikë dhe Evropë, pasi kur kërkohet të punësohet një pedagog, kriteri i parë dhe më i rëndësishëm është që kandidati të ketë një PhD, ta ketë në fushën përkatëse, të ketë kërkim shkencor dhe plane botimi si dhe të jetë në gjendje të japë mësim një numër lëndësh që kanë lidhje direkte me fushën.

Universiteti i Tiranës në shpalljen e vendit të punës thotë se kandidati duhet të ketë “Doktoraturë” por në vlerësimin konkret, përdor si “metër matës” diplomën e bachelorit, i cili nuk mund të aplikohet në emër të interesit të universitetit dhe studentëve.

Përmes kësaj ankese, [REDAKTUAR] ka kërkuar nga Komisioneri që të konstatojë se praktikat e ndjekura nga Universiteti i Tiranës janë diskriminuese jo vetëm për të, por dhe ndaj të gjithë personave që kanë përfunduar doktoraturën jashtë vendit .

Në zbatim të parashikimeve ligjore në nenet 32 dhe 33 të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë veprimet e pasqyruara në vijim.

Me shkresën nr. 937/1, datë 24.11.2015 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjektivit Universiteti i Tiranës, në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga z. [REDAKTUAR]

Me shkresën Nr. 1165/5, datë 14.12.2015 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Fakulteti i Shkencave Sociale i Universitetit të Tiranës informon se: “Aplikimet për punë të z.Çata nuk janë pranuar nga ana e Fakultetit të Shkencave Sociale për dy arsye. Së pari nuk plotëson kriterin e notës mesatare të ciklit bachelor (mbi 8) dhe të masterit (mbi 8), pasi z. [REDAKTUAR] ka mbaruar studimet universitare në degën Gjuhë-Letërsi me mesatare 7.96 dhe jo mbi 8. Së dyti, nuk plotëson kriterin që të jetë i diplomuar të paktën në dy cikle në fushën e shkencave politike. Për të plotësuar këtë kriter, kandidati duhet të kishte të paktën Master Shkencor në fushën e Shkencave Politike (të njehsuar nga MAS) dhe Doktoraturë në Shkenca Politike (të njehsuar nga MAS), pra të paktën ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve. Z. [REDAKTUAR] disponon “Master of Arts” (të njehsuar nga MAS). Fituesit për vendet e lira të punës të shpallur në Buletinin e APP-së janë kandidatët të cilët plotësonin kriteret e përgjithshme dhe ato preferencialë....”.

Me shkresën nr. 937/2, datë 24.11.2015, nga KMD i është kërkuar subjektivit ankues plotësimi i dokumentacionit dhe informacion shtesë në lidhje me ankesën.

Me shkresën nr. 61 datë 14.01.2016 të KMDs-së janë njoftuar palët për realizimin e një seance dëgjimore mes tyre, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet lidhur me ankesën në fjalë.

Më datë 21.01.2016 në mjediset e zyrës së Komisionerit u zhvillua seanca dëgjimore, ku morën pjesë, juristja pranë Universitetit të Tiranës [REDAKTUAR] dhe subjekti ankues.

Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore ankuesi ka deklaruar se: “Refuzimi i aplikimit të tij nga Fakulteti i Shkencave Sociale është diskriminues për shkak të origjinës amerikane të formimit të tij profesional dhe akademik, të superioritetit të formimit të tij akademik në nënfusha të shkencave politike ashtu dhe në metodologji si dhe për shkak të qëndrimeve dhe ideve të tija të spikatura publikisht, të cilat kanë qenë jo thjesht kritike të gjendjes në universitetet shqiptare por dhe kanë kërkuar bërjen e ndryshimeve. Sipas ankuesit diskriminimi i tij për shkak të gjendjes arsimore, përfaqëson nga ana e universitetit një praktikë diskriminuese në raport me kandidatët e tjerë konkurrues duke përdorur kriterin e notës mesatare dhe të diplomimit në dy cikle në fushën e shkencave politike”.

Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, përfaqësuesja e Universitetit të Tiranës ka deklaruar se: “Nevoja për vendosjen e kriterit të diplomimit në dy cikle në fushën e shkencave politike nga ana e departamentit, ka qenë për arsye se departamenti i shkencave politike është i ri, i krijuar në vitin 2008, me përbërje fillimisht personel akademik të formimit të përgjithshëm në shkenca sociale ose me kualifikime të përafërta në këtë fushë dhe për këtë arsye kandidatët duhet të jenë të kualifikuar në vijimësi në dy cikle për shkenca politike, ndërsa kriteri i vendosjes së mesatares së lartë ka të bëjë me cilësinë e kandidatit dhe është kriter që vendoset në çdo konkurrim pune të çdo fakulteti. Znj. [REDAKTUAR] shpjegoi se vendosja e kriterëve vlerësohet nga nevojat që kanë departamentet për staf mësimor dhe mund të jenë të ndryshme”.

Me shkresën nr.137/2, datë 28.01.2016, Rektorati i Universitetit të Tiranës ka informuar Komisionerin mbi ankesën e paraqitur, duke parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të detajuar procedurat e ndjekura për konkursin për punonjës mësimor në Departamentin e Shkencave Politike.

Me shkresën nr. 575, datë 31.05.2016 i është kërkuar Universitetit të Tiranës të japë shpjegime në lidhje me proporcionalitetin e vendosjes së kriterit përjashtues të notës mesatare mbi 8 në ciklin bachelor, në rastin kur një kandidat ka përfunduar me sukses dy cikle studimi (master dhe doktoraturë) në fushën e kërkuar, arsyetimin e përdorur nga departamenti për vendosjen e këtyre kriterëve si dhe nëse vendosja e këtyre kriterëve për rekrutimin e stafit akademik i referohet ndonjë eksperience në Universitetet Evropiane apo të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Me shkresën nr.137/5, datë 09.06.2016, Rektorati i Universitetit të Tiranës ka informuar Komisionerin si më poshtë: “Universiteti i Tiranës në praktikën e deritanishme të ndjekur, gjithmonë në një procedurë punësimi është kërkuar nota mesatare e studimeve si një tregues i cilësisë dhe profesionalizmit. Kriteret e punësimit përcaktohen nga njësia bazë sipas nevojave që ka departamenti në bazë të lëndëve dhe të ngarkesës mësimore të pedagogut. Në Statutin dhe Rregulloren e UT nuk ka një rregullim apo përcaktim mbi mënyrën e përcaktimit të kriterëve të punësimit për staf pedagogjik. Universiteti i Tiranës sqaron se, për vendosjen e kriterëve të punësimit, bazohet në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin dhe Rregulloren e UT si dhe në praktikat më të mira që janë ndjekur deri më tani”.

KMD, pasi ka marrë në analizë pretendimin e subjektit ankues se është diskriminuar për shkak të gjendjes arsimore përmes procedurës së punësimit për personel akademik, ka arritur në përfundimin se nuk ka patur trajtim më pak të favorshëm të [REDAKTUAR] krahasuar me aplikantët e tjerë, pra se ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë nga ana e Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale në krahasim me aplikuesit e tjerë, për shkak të gjendjes arsimore .

Lidhur me pretendimin tjetër të ankuesit se kriteret e përgjithshme të vendosura në konkurrimin për vendet e lira për personel akademik janë diskriminuese, KMD ka pranuar ankimin duke konkluduar se kandidatët që kanë të mbrojtur një gradë apo titull shkencor (të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit) si doktor, docent, profesor i asociuar, profesor, diskriminohen në mënyrë të tërthortë nga vendosja e kriterit të notës mesatare të ciklit të I dhe të II të studimit.

Në përfundim të hetimit administrativ, pasi ka mbledhur informacionin e nevojshëm dhe ka vlerësuar në referim të ligjit situatën e ankuesit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me vendim nr.140 datë 23.09.2016, ka vendosur:

- 1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasit [REDAKTUAR], nga ana e Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, lidhur me procedurën e rekrutimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve për vendet e punës në Departamentin e Shkencave Politike, për shkak të gjendjes arsimore.*
 - 2. Konstatimin e diskriminimit të tërthortë të kandidatëve që kanë të mbrojtur një gradë apo titull shkencor (doktor, docent, profesor i asociuar, profesor) për shkak të gjendjes arsimore.*
 - 3. Në referim të pikës 2, Fakulteti i Shkencave Sociale, rekomandohet që të vendosë kriteret të diferencuara sipas shkallës së kualifikimit të kandidatëve.*
 - 4. Universiteti i Tiranës, rekomandohet që të parashikojë në aktet nënligjore, detyrimin e njësisive bazë për të shpjeguar me shkrim në mënyrë të arsyetuar vendosjen e kriterëve të propozuara.*
 - 5. Bazuar në nenin 33, pika 11, të ligjit nr.10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave Sociale detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.*
 - 6. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

Në pjesën arsyetuese të këtij vendimi për pjesën e pranuar të ankimit, KMD, ndër të tjera analizon si më poshtë vijon:

"Referuar legjislacionit në fuqi dhe dokumentacionit të shqyrtuar në lidhje me procedurat e punësimit për personelin mësimor, vërehet se në aktet e përmendura nuk ka një rregullim të saktë dhe të qartë mbi mënyrën e përcaktimit të kriterëve të punësimit për staf pedagogjik si dhe nuk është përcaktuar detyrimi që duhet të kenë njësitë përkatëse (Departamenti) për të shpjeguar me shkrim në mënyrë të arsyetuar vendosjen e kriterëve të propozuara.

Duke iu përmbajtur kritereve të përcaktuara në Buletinin nr.38, datë 28.09.2015, rezulton se në bazë të tij, përjashtohen nga konkurrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjithë kandidatët që kanë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master nën 8, si dhe të cilët nuk janë diplomuar të paktën në dy cikle në fushën e shkencave politike, pavarësisht se mund të jenë me tituj shkencorë më të lartë se kriteret e kërkuara. Ky kriter bëhet dhe më i pakuptimtë kur kandidati plotëson kriterin e diplomimit në master dhe doktoraturë në fushën e shkencave politike por studimet e ciklit bachelor i ka në një degë tjetër, kusht në të cilin ndodhet ankuesi dhe ndonjë kandidat i skualifikuar...” (shih faqet nr.8-9 të vendimit 140/2016 të KMD).

Vendimi nr.140 datë 23.09.2016 i është komunikuar Universitetit me shkresën e KMD nr.875/1 prot datë 23.09.2016.

Pala paditëse i është drejtuar gjykatës administrative të shkallës së parë Tiranë, me objekt të padisë shfuqizimin e vendimit objekt gjykimi.

Me shkresën nr.137/10 prot datë 26.10.2016, Rektorati pranë UT, në zbatim të pikës 5 të vendimit 140/2016 të KMD-së, njofton këtë të fundit se ka depozituar ankim gjyqësor lidhur me pikat 2 dhe 3 të vendimit, ndërsa lidhur me pikën 4 të tij, ndodhet në fazën e hartimit të akteve të brendshme (Statut dhe Rregullore), në të cilat do të parashikohet detyrimi i lënë njësisive bazë për të shpjeguar me shkrim në mënyrë të arsyetuar vendosjen e kritereve të propozuara.

Kolegji Administrativ i Apelit, pa i hyrë shqyrtimit në themel të çështjes vlerëson se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka lejuar shkelje të rënda procedurale të tilla që e vënë në pengesë kolegjin të shqyrtojë themelin e çështjes, ndaj ai e ndal arsyetimin e tij në këtë moment procedural.

Parimi i barazisë së armëve nënkupton se, çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njëjës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj për të garantuar një proces të rregullt ligjor, qëndrim ky i mbajtur edhe nga Gjykata Kushtetuese në Vendimin nr. 3, datë 23.01.2014, vendimin nr. 34, datë 25.07.2011 dhe vendimin nr. 23, datë 08.06.2007.

Në vijim të kësaj logjike juridike, konstatohet se, për sa kohë që rezultoi i provuar interesi i shtetasit Edmond Çata në çështjen në gjykim, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë kishte detyrimin për ta thirrur si palë të interesuar, e të zhvillojë në këtë mënyrë një proces të rregullt ligjor, si në aspektin procedural ashtu edhe në atë material disponim i cili gjykatës i buron nga neni 193 të Kodit të Procedurës Civile. Për sa më sipër, në kushtet kur nuk rezulton që gjykata të ketë kryer një hetim të plotë mbi çështjen, orientimin e tyre në lidhje me ndërgjyqësinë dhe as ushtrimin e të drejtës për thirrjen si person të tretë të shtetasit Edmond Çata, ky kolegji vlerëson se nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë janë lejuar shkelje të rënda procedurale, për të cilat ligji parashikon shprehimisht pavlefshmërinë e procedurës së gjykimin.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, në kushtet e konstatimit të aspekteve procedurale si më sipër, nuk mund të analizojë dhe të marrë në shqyrtim pretendimet e palëve të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit material. Të gjitha këto pretendime do të merren në shqyrtim dhe do të analizohen nga gjykata administrative, pasi të orientohet pala në proces që të thërrasë si palë të tretë shtetasin [REDAKTUAR] i cili është ankuesi ndaj vendimeve të ndërmarra nga pala paditëse për të cilat ai në një procedurë administrative parashitroi kërkesën ankimore pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili në përfundim të hetimit administrativ ka marrë vendimin objekt gjykimi. Në këto kushte ky kolegji vlerëson se nga gjykata nuk janë respektuar rregullat procedurale në lidhje me ndërgjyqësinë, pasi në proces do të duhej të ishte thirrur me cilësinë e personit të tretë ankuesi i procesit administrativ, pasi kjo vendimmarrje është rezultat i ankimit të tij e për pasojë ai tërheq interesa në këtë proces.

Neni 50 i ligjit nr. 49/2012 parashikon;

Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit në dhomë këshillimi

Gjykata Administrative e Apelit në dhomë këshillimi vendos:

- a) mospranimin e ankimit, në rastet kur ankimi nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë dhe gjykata administrative e shkallës së parë nuk e ka bërë një gjë të tillë;
- b) lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë;
- c) ndryshimin e vendimit;
- ç) prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim, në rastet kur shkeljet procedurale janë të rënda dhe për të cilat ligji parashikon shprehimisht pavlefshmërinë e vendimit apo të procedurës së gjyqimit;

Në Nenin 1/2 të Ligjit Nr.49/2012, parashikohet se:

“Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedures Civile, me përjashtim të rasteve dhe për atë që ky ligj nuk parashikon ndryshe”.

Konkretisht, Neni 467/d i K.Pr.Civile parashikon se:

“Gjykata e apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e dërgon çështjen për rigjykim kur:

d) nuk është formuar drejt ndërgjyqësia”.

Këtë qëndrim ka mbajtur edhe kolegji administrativ i gjykatës së lartë në vendimin Nr.00-2014-1978 Vendimi (428) datë 12.06.2014 i cili midis të tjerave arsyteon:

15. Kolegji Administrativ vlerëson se, pretendimet e mësipërme të ngritura në rekurs nga pala e paditur [REDAKTUAR] janë të bazuara në ligj, pasi kërkohet që një akt administrativ të konstatohet absolutisht i pavlefshëm dhe organi administrativ që ka nxjerrë aktin nuk është thirrur si palë në gjykim. Duhet theksuar se në gjykimin e mëparshëm kur shqyrtoheshin bashkë padia dhe kundërpadia Komisioni i Ndarjes së Tokës Mamurras ka qenë i thirrur në gjykim nga paditësi me cilësinë e personit të tretë, por pas kthimit të çështjes nga Gjykata e Lartë, gjykata e shkallës parë, që ka patur si objekt gjykimi vetëm kundërpadinë nuk e ka thirrur më në gjykim këtë Komision si person të tretë, por është mjaftuar me thirrjen në këtë cilësi vetëm të ZVRPP Kurbin, veprim i cili është në kundërshtim me ligji procedural, pasi organi që ka nxjerrë aktin administrativ që kundërshtohet në gjykatë duhet të thirret patjetër si palë në gjykim.

16. Në vitin 2000 i padituri [REDAKTUAR] a i ka shitur shtetasit [REDAKTUAR] në pjesë të kësaj prone me sipërfaqe 4.513 m² dhe megjithëse ky shtetas heq të drejta pronësie që i vijnë nga një akt administrativ që kontestohet në një proces gjyqësor, ku ai nuk është thirrur në gjykim, prandaj gjykata e shkallës së parë ishte e detyruar që të zbatonte kërkesat e nenit 193 të K.Pr.Civile, pasi ky shtetas ka interesa për zgjidhjen e çështjes.

17. Në nenin 467/1 germa "d" të K.Pr.Civile është parashikuar se: Gjykata e apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e dërgon çështjen për rigjykim kur nuk është formuar drejtë ndërgjyqësia dhe meqenëse ajo e ka lejuar këtë shkelje të rëndë të rregullave procedurale Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, vendimet e gjykatave duhet të prishen dhe duke u bazuar në vendimin unifikues nr.03/2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë çështja i kalon për rishqyrtim Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila pasi të formojë drejt ndërgjyqësinë duhet t'i hyjë gjykimin në themel të çështjes.

Ndërsa në vendimin Nr.00-2014- 1548 i Vendimit (277) datë 22.05.2014, kolegji administrativ i Gjykatës së Lartë midis të tjerave arsyeton:

*"Në të tilla rrethana të faktit dhe të ligjit, Kolegji Civil vëren se ndërgjyqësia është e gabuar. Gjykata e shkallës së parë, pas shtimit të objektit të padisë me kërkimin për urdhërimin e ZRRPP Kuçovë për të regjistruar pronën objekt gjykimi, meqenëse nuk po dispononte vetë paditësi, me të drejtë ka thirrur kryesisht në cilësinë e personit të tretë edhe ZRRPP Kuçovë. **Por, gjatë gjykimin, paditësi [REDAKTUAR] nuk ka kërkuar të disponojë për thirrjen e kësaj palë në pozitën procedurale të të paditurit, ndonëse me vetë padinë e ngritur prej tij kërkon drejtpërdrejt detyrimin e kësaj pale të regjistrojë truallin në pronësi të tij. Kjo gjendje duhet të sillte gjykatën në një vendimmarrje tjetër lidhur me zgjidhjen e çështjes.***

Megjithatë, nisur nga natyra e mosmarrëveshjes në gjykim, gjykata e shkallës së parë ka zbatuar gabim ligjin material dhe për rrjedhojë edhe ligjin procedural kur nuk ka disponuar edhe kryesisht për thirrjen si person të tretë të Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike pranë Ministrisë së Financave, e cila, pas suprimimit të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, ishte autoriteti shtetëror që, sipas ligjit, kujdeset për mbrojtjen dhe kryen procedurat e privatizimit nëpërmjet tjetërsimit të pronave shtetërore. Në kushtet

kur BSPSH nuk ka patur titull pronësie mbi truallin objekt gjykimi dhe as nuk e ka patur të regjistruar atë, paditësi konfliktin për të drejtën subjektive që pretendon në gjykim e ka me Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike pranë Ministrisë së Financave, nga e cila kërkohet dhe bëhet kalimi i pronësisë së truallit pronë shtetërore në pronë private.

Kolegji Civil vëren se në çështjen objekt gjykimi, formimin e gabuar të ndërgjyqësisë nuk e ka riparuar as edhe nga ana e gjykatës së apelit.”

Duke u bazuar në sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 50, gërma “ç” të Ligjit Nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, përfundimisht vlerëson se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë duhet të priset dhe çështja duhet dërguar për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, në bazë të nenit 50/ç të ligjit Nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

VENDOSI

- Prishjen e vendimit nr. 304 dt. 06.02.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë po me tjetër trup gjykues.
- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë, brenda 30 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall sot më 05.02.2020 në Tiranë.

ANËTAR

Amarildo LAÇI
d.v

ANËTAR

Bari SHYTI
d.v

KRYESUESE

Alkelina GAZIDEDJA
d.v

**Vërtetohet njësia me origjinalin
KANCELAR**

Kancelari
Leonard Shyti
Shyti

